



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2020

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor shpall vend të lirë pune për:

- **1 (një) Specialist Mjek në Sektorin e Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe Spitalor pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë.**

Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë janë:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbush kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces në prokurori apo gjykatë;
- Të mos jetë pushuar më parë nga administrata e FSDKSH-së apo shërbimi Civil për thyerje të disiplinës a shkelje të tjera serioze;
- Të ketë mbaruar Fakultetin e Mjekësisë;
- Të jetë i pajisur me diplomën përkatëse;
- Vjetërsia në punë përbën avantazh;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh. (dëshmi,çertifikata)
- Të zotërojë kompjuterin në programet bazë Word dhe Exel;
- Të jetë i komunikueshëm.

Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentat pranë Drejtorisë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë, **brenda datës 09.06.2020**, këto dokumenta;

- Kërkesë me shkrim për t'u punësuar;
- Përshkrimin e edukimit dhe karrierës profesionale (curriculum vitae).
- Diplomë e noterizuar;
- Diplome Master e noterizuar;
- Listë notash e noterizuar;
- Dëshmi për kualifikime të ndryshme si kurs kompjuteri, gjuhën e huaj;

- Referencë pune nga vendi ose vendet e punës ku ka punuar;
- Librezën e punës;
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Dëshmi penaliteti jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes pranë DRFSDKSH-së Gjirokastrë;
- Raport mjekësor për aftësi në punë jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes pranë DRFSDKSH-së Gjirokastrë;

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentat të dorëzohen në zarf të mbyllur, i cili protokollohet.

Adresa:

Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë.